

Konkurs për Praktikë

Demokrasi për Zhvillim (D4D) shpall konkurs për **2 Praktikantë/e** për t'u angazhuar në aktivitetet brenda fushave të veprimit të D4D-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Përkrah dhe ndihmon në aktivitetet e D4D-së si tryeza, konferenca, fokus grupe, fushata avokuese etj;
- Asiston në hulumtim dhe shkrim të raporteve të ndryshme nën delegim të mbikëqyrësit/es;
- Ndihmon rreth punëve administrative të organizatës;
- Punë tjera sipas nevojës.

Kriteret

- Të jeni të moshës 18-25 vjeç;
- Të jeni student/e i/e vitit të fundit apo i/e posadiplomuar në fakultetet e shkencave sociale (përparësi do të kenë ata/o që kanë eksperiencë në fushat e ndërlidhura me siguri).
- Njohuri të shkëlqyeshme në të folur dhe të shkruar të gjuhës shqipe dhe angleze (njohja e gjuhës serbe është përparësi);
- Njohuri të mirë të punës me kompjuter.

Ne ofrojmë:

- Mundësi rritjeje profesionale;
- Angazhim me një staf profesional;
- Kushte shumë të mira të punës;

Konkursi është i hapur deri më **06 Dhjetor, 2017**. Aplikoni duke dërguar CV-në tuaj në email adresën vacancies@d4d-ks.org. Vetëm kandidatët/et të cilët/at do të përzgjidhen në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së vizitoni faqen elektronike www.d4d-ks.org.